



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-101

LIGJ PER FALJEN

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Në pajtim me paragrafin (29) të Nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PER FALJEN

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i Ligjit

Ky ligj i përcakton autorizimet ligjore të Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje të faljes individuale

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij ligji:

“Falje” nënkupton pushtetin e jashtëzakonshëm ekzekutiv të Presidentit për t’i falur personat e dënuar për vepër penale, duke i liruar nga dënimi i përcaktuar nga gjykata;

“Person i Dënuar” nënkupton personin e dënuar me anë të një vendimi përfundimtarë nga ndonjë gjykatë e Kosovës;

“Kërkesë” nënkupton kërkesën për falje sipas këtij ligji;

“Ministria” nënkupton Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës;

“Presidenti” nënkupton Presidentin e Republikës së Kosovës;

“Rehabilitim” nënkupton rikthimin e të gjitha të drejtave civile një personi të dënuar, duke përfshirë edhe rehabilitimin ligjor sipas nenit 87 të Kodit Penal të Kosovës.

Neni 3

Parimet për Falje

1. Falja është e drejtë e presidentit që ka për qëllim përdorimin e një mjeti jo të rregullt e të rrallë për t’i shpërblyer sjelljet dhe karakteret e jashtëzakonshme ose t’i adresojë shqetësimet e jashtëzakonshme humanitare
2. Presidenti, me falje liron të dënuarin nga të gjitha dënimet që i janë ngarkuar me anë të një vendimi gjyqësor përfundimtarë.
3. Falja e liron të dënuarin nga vuajtja e dënimit, nga masat mbrojtëse, nga gjobat dhe nga çdo dënim tjetër të përfshirë në dënimin e shqiptuar nga gjykata
4. Falja i ofron personit të dënuar rehabilitim të menjëhershëm.
5. Falja nuk ofron të drejtën për kompenzim financiar ndaj personit të falur.
6. Falja e personit të dënuar nuk ndikon tek të drejtat apo obligimet e personave tjerë të përcaktuara me të njëjtin vendim gjyqësor që është prekur nga Falja.
7. Kërkesa për falje nuk e ndërprejnë ekzekutimin e dënimit.

Neni 4

E drejta për të kërkuar Falje

1. Vetëm personi i shpallur fajtor për vepër penale dhe i dënuar me vendim përfundimtarë nga ndonjë gjykatë e Kosovës gëzon të drejtën për tu falur nga Presidenti, përveç në rastet e parapara në këtë nen.
2. Personat e dënuar jashtë Kosovës, që janë duke e vuajtur dënimin në Kosovë, kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për falje
3. Personi i cili me qëllim i shmanget ekzekutimit të dënimit për veprën penale nuk ka të drejtë të kërkojë falje.
4. Personi i dënuar, kërkesa e të cilit është refuzuar nga Presidenti nuk ka të drejtë të kërkojë falje për veprën e njëjtë penale, përveç nëse mund të dëshmohet se janë paraqitur rrethana të reja që nga refuzimi i kërkesës së mëparshme.
5. Personi i dënuar në bazë të Kreut XIII apo Kreut XIV të Kodit Penal të Kosovës, për veprën penale kundër Kosovës apo qytetarëve të saj apo kundër të drejtës ndërkombëtare nuk ka të drejtë të kërkojë falje.

Neni 5

Kriteret për Falje

1. Kriteret të cilat shqyrtohen gjatë marrjes së vendimit mbi Faljen caktohen nga Presidenti në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin në fuqi.
2. Rrethanat që mund të shqyrtohen gjatë dhënies së faljes përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
 - 2.1. pesha e krimit;
 - 2.2. rreziku i recidivizmit;
 - 2.3. pendimi i sinqertë;
 - 2.4. shfaqja e sjelljeve dhe karakterit të respektueshëm.

KREU II

PROCEDURAT PËR FALJEN

Neni 6

Paraqitja e kërkesës për Falje

1. Kërkesa për falje paraqitet me shkrim nga personi i dënuar. Në emër të personit të dënuar kërkesa mund të bëhet edhe nga bashkëshorti, bashkëshortja, fëmija, vëllai, motra ose nga ndonjë person tjetër i autorizuar nga personi i dënuar
2. Kërkesa duhet t'i drejtohet Presidentit.
3. Kërkesa duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër të rastit, deklarin e fakteve, rrethanat dhe arsyet në mbështetje të kërkesës për Falje, ndonjë informacion tjetër që mund të konsiderohet si i nevojshëm nga personi që paraqet kërkesën dhe çdo lloj informacioni tjetër që mund të jetë i nevojshëm.
4. Kërkesa mund të tërhiqet në çdo kohë si nga personi i dënuar ashtu edhe nga personi që ka bërë kërkesën në emër të të dënuarit.

Neni 7

Shqyrtimi i kërkesave për Falje

1. Me rastin e marrjes së kërkesës për Falje, Presidenti mund ta udhëzoj Ministrinë që të mbledh informatat e nevojshme.
2. Ministria, në bazë të kërkesës së Presidentit i mbledh të gjitha të dhënat personale në lidhje me personin e dënuar, të mbajtura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, si dhe e njofton gjykatën që ka marrë vendim mbi çështjen e tillë, prokurorinë dhe palën e dëmtuar.
3. Nëse kërkohet nga Presidenti, Ministria mbledh informata shtesë nga burimet e saj apo nga burime tjera.
4. Pas mbledhjes së informatave të nevojshme, Ministria ia dërgon ato Presidentit.

Neni 8

Vendimi mbi kërkesën për Falje

1. Presidenti shpall Falje me anë të Dekretit i cili publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Kur Presidenti shpall Falje, njoftohet personin që ka bërë kërkesën, personi që falet dhe Ministria .

3. Kur Presidenti refuzon kërkesën për Falje, pa vonesë njoftohet personi që ka bërë kërkesën, personi i dënuar dhe Ministria .

4. Dekreti i Presidentit për Falje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit, përveç nëse parashihet ndryshe. Ministria duhet ta zbatojë Dekretin brenda dyzetetetë (48) orësh nga marrja e lajmërimit nga Presidenti.

KREU III

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 9

Zbatueshmëria

Ky ligj zbatohet vetëm për kërkesat për Falje të paraqitura pas hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Neni 10

Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-101
12 dhjetor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI